

Emina Zhivkoviç

Disa çështje për “demokracinë” në Mbretërinë SKS





Pyetja kyçe

Deri në cilën masë diktatura e tregon forcën ose dobësinë e shtetit?



Tema

Punëtorja ka të bëjë me çështjet politike në Mbretërinë SKS gjatë kohës së diktaturës së mbretit Aleksandër dhe ndikimit të faktorëve politikë në jetën e përditshme të njerëzve të rëndomtë. E përfshinë periudhën nga vitit 1929 deri në vitin 1934. Kjo temë është zgjedhur sepse në tekstet tona mësimore kjo çështje nuk përpunohet në këtë mënyrë, si edhe për shkak se disa probleme politike janë të ngjashme me të sotmet. Gjithashtu, gjysma e parë e shek. XX është shënuar me luftë të pandërprerë mes demokracisë dhe diktaturës në tërë regjionin.



Rezultatet e mësimimit

1. Nxënësit do ta vërejnë lidhjen mes rrethanave politike dhe vendosjen e diktaturës.
2. Nxënësit do t'i analizojnë burimet historike dhe në bazë të analizës do t'i formulojnë konkluzionet.
3. Nxënësit do ta vërejnë lidhjen mes vendosjes së diktaturës dhe pozitës së njerëzve të zakonshëm.



Qëllimet

- Kuptimi kritik i natyrës së ndërlikuar të së kaluarës
- Kuptimi i botës sot
- Pikëpamje ndërkombëtare
- Respektim të të drejtave të njeriut
- Vetëdije historike



45
minuta

Udhëzime për mësimdhënësin

HAPI 1: Mësimdhënësi e lexon hyrjen, ndërsa pastaj burimet për emblemat shtetërore, flamurin, himnin kombëtar, hartën, kushtetutën dhe pyetjet që i çojnë studentët në përgjithësi drejt konkluzioneve.

HAPI 2: Mësimdhënësi i ndan nxënësit në tre grupe. Grupi i parë është diktatori dhe administrata, grupi i dytë janë njerëzit e rëndomtë dhe grupi i tretë janë përfaqësuesit e huaj. Nxënësit duhet të angazhohen në luajtjen e roleve kur çdo grup duhet të raportojë para përfaqësuesit të Lidhjes së Kombeve që kanë ardhur të interesohen për situatën në Jugosllavi.

HAPI 3: Punë në grupe

HAPI 4: Diskutim

Secili grup ka detyrë të njëjtë – ta plotësojë tabelën dhe t'i prezantojë rezultatet.

Përderisa nxënësit punojnë në grupe, mësimdhënësi mund t'i shkruajë përgjigjet e propozuara në dërrasë dhe përderisa nxënësit janë duke i prezantuar rezultatet.

Hyrje

Mbretëria e SKS është themeluar pas Luftës së Parë Botërore nga rajonet të cilat kishin trashëgimi të ndryshme kulturore. Dallimet (nacionale, ekonomike, kulturore...) e rëndonin shtetin deri në atë masë sa që kuvendi u bë plotësisht institucion jofunksional dhe vend i atentateve politike ndaj udhëheqësve politikë. E tërë kjo e provokoi mbretin që të sjellë vendim, për atë kohë të zakonshëm, për shpalljen e diktaturës. Shpjegimi i tij ishte se ai dëshironte ta ndalë gjendjen kaotike në vend, por shumica këtë vendim e përjetuan si dhunë të pastër politike.

Burimi 1

Simbolet kombëtare dhe himni i Mbretërisë së Jugosllavisë

Zot i drejtësisë, ti që na shpëtove,
neve nga shkatërrimi gjer tani!
Dëgjo që sot zërat tanë
dhe që sot bëhu shpëtimtari i jonë!

Atdheu ynë i bukur,
o vend i dashur trim,
lavdia e vjetër e gjyshërve tanë,
qofsh i lumtur përgjithmonë!

Përpara flamuri i lavdisë,
në luftë drejt gjakut të trimërisë,
për të mirën e atdheut,
le të flasin pushkët!

Zot na shpëto, zot na ruaj,
mbretin tonë dhe njerëzit tanë!
Mbretin Petar, Zot ruaje,*
Ne të gjithë të lutemi ty!

*Rreshti i tretë i strofës së fundit është ndryshuar në "Mbretin Aleksandër, Zot ruaje" gjatë sundimit të Aleksandërit I të Jugosllavisë



National symbols, Mozaik proslosti, Bigz 2010

Burimi 2

Harta e Evropës që pasqyron pozitën e Mbretërisë së SKS



http://sh.wikipedia.org/wiki/Kraljevina_Jugoslavija, 5.03.2012.

Burimi 3

Kushtetuta e "Vidovdadnit"¹ – Nenet e kushtetutës që i japin pushtet të gjerë Mbretit

¹ Quhej me këtë emër sepse u soll në ditën e Shën Vidit – Vodovdan (28 qershor)

Kushtetuta

Neni 46

"Pushtetin kushtetues e kryen Mbreti dhe Kuvendi popullor bashkërisht"

Neni 47

"Pushtetin administrativ e kryen Mbreti nëpërmjet ministrave përgjegjës, sipas urdhërave të kësaj Kushtetute"

Neni 49

"Mbreti i vërteton dhe i shpall ligjet, i vendos zyrtarët shtetërorë dhe jep grada ushtarake sipas normave ligjore. Mbreti është urdhëruar i përgjithshëm i të gjitha forcave ushtarake".

Neni 51

"Mbreti e përfaqëson shtetin në të gjitha marrëdhëniet e tij me shtetet tjera. Ai shpall luftë dhe lidh paqe".

Neni 52

"Mbreti e thirr Kuvendin Popullor (...) Mbreti ka të drejtë ta shpërndajë Kuvendin Popullor".

Neni 55

"Autoriteti i mbretit është i paprekshëm. Mbreti nuk mund të merret në përgjegjësi, Mbreti për asgjë nuk mund të gjykohej. Kjo nuk vlen për pronën private të Mbretit".

Price iz XX veka, Platoneum, 2002.

Burimi 1

Administrata dhe korrupsioni – perceptimi i Ambasadorit Britanik në Mbretërinë e SKS

Në të gjitha provincat ekziston një kërkesë e përgjithshme për barazi me Serbinë. Është mjaft e sigurt se as autoritet e Beogradit nuk e kanë të lehtë të bisedojnë me demagogët e papërgjegjshëm të cilët i kontrollojnë masat e fshatarëve kroatë, por kanë ndikuar edhe në mënyrë centraliste... gjithashtu nuk ndihmoi në implementimin e ndonjë ligji ose reforme praktike administrative... dhe krijoi pakënaqësi që u shfaq pas likuidimeve në Kuvend verën e kaluar.

... U formuan 25 qeveri në Beograd gjatë 10 viteve të kaluara, dhe të gjitha ata merreshin me politika të vogla, lokale, që paraqet argëtim kryesor në Ballkan, në vend që të ballafaqohen me problemet e ngutshme për t'u kujdesur për gjendjen në vend.

Zivko Avramovski, "Britanci u Kraljevini Jugoslaviji", Zagreb, 1988.

Burimi 2

Analfabetizmi në provinca (Banovina)

			Lexojnë dhe shkruajnë			Lexojnë	analfabetë
Banovina	M	F	Gjithsejtë	M	F	Gjithsejtë	Gjithsejtë
Dravska	94,13%	92,41%	93,23%	1,80%	1,23%	1,23%	5,54%
Drinska	56,37%	18,56%	37,49%	0,32%	0,42%	0,40%	62,11%
Dunavska	82,03%	59,67%	70,52%	0,45%	0,77%	0,61%	28,87%
Moravska	60,76%	16,01%	37,70%	0,41%	0,27%	0,34%	61,96%
Primorska	55,48%	29,37%	42,08%	0,41%	0,51%	0,46%	57,46%
Savska	80,06%	63,78%	71,60%	0,37%	1,07%	0,73%	27,67%
Savska	80,06%	63,78%	71,60%	0,37%	1,07%	0,73%	27,67%
Vardarska	43,89%	14,32%	28,84%	0,41%	0,18%	0,30%	70,86%
Vrbska	39,73%	13,95%	27,09%	0,38%	0,24%	0,31%	72,60%
Zetska	50,69%	16,69%	33,50%	0,51%	0,41%	0,46%	66,04%
Beogradi	92,66%	84%	88,69%	0,24%	0,68%	0,44%	10,87%
Ukupno	67,31%	42,90%	53,83%				44,51%

Illiteracy, Ljubodrag Dimić, Kulturna politika Kraljevine Jugoslavije 1918'1941, II, str.192

Izvor 3

Numri i përgjithshëm i analfabetëve në Mbretërinë e SKS

Në disa zona analfabetizmi ishte më i madh se 80%, kryesisht në mesin e femrave. Vetëm katër vite shkollim fillor ishin të obligueshme në bazë të ligjit në fuqi. Kishte vetëm tre Universitete në tërë shtetin, në Beograd, Zagreb dhe Lubjanë. Kishte nga një fakultet në Shkup dhe Subotice.

analfabetë	
1921	1931
51,5%	44,0%

Illiteracy, Ljubodrag Dimić, Kulturna politika Kraljevine Jugoslavije 1918'1941, II, str.192

Burimi 4

Perceptimi i analfabetizmit nga ambasadori Britanik në Mbretërinë SKS në vitin 1925.

Shkalla e lartë e analfabetizmit në viset jugore është çështja kryesore që duhet t'i kushtohet kujdes, ndërsa shkollat fillore nuk hapen vetën me nismën e qeverisë, por edhe me pagesë private të fshatarëve. Vlerësohet se në Bosnje dhe Maqedoni shkollën e ndjekin dy herë më tepër nxënës se para 7 viteve...

State initiatives, Živko Avramovski, "Britanci o Kraljevini Jugoslaviji" - godišnji izveštaji britanskog poslanstva u Beogradu- 1986, Arhiv Jugoslavije, Beograd, Globus, Zagreb

Burimi 5

Likuidimi në Kuvend

Atë 20 qershor të vitit 1928, Punisha Raçiq nga foltorja e Kuvendit gjuajti nga revolja në drejtim të Pavle Radiqit, Stepan Radiqit, Gjuro Basariçekut, Ivan Grangjit dhe Ivan Pernarit. Ky ishte shkaku i vendosjes së diktaturës.



http://en.wikipedia.org/wiki/Stjepan_, 28.03.2012

Burimi 6

Proklamimi i diktaturës

"Ka ardhur koha që nuk duhet të ketë ndërmjetësues mes popullit dhe Mbretit".
 "...Parlamentarizmi i cili si mjet politik, sipas traditave të babait tim të paharruar, mbeti edhe ideali im, filloi të keqpërdoret dhe u bë pengesë për çfarëdo pune të dobishme në vend... Në vend që parlamentarizmi të zhvillojë dhe forcojë frymën e bashkimit popullor dhe shtetëror, ai – kështu siç është – bën përçarje shpirtërore dhe popullore... Prandaj, vendosa për ta pezulluar Kushtetutën e Mbretërisë së SKS të 21 qershorit 1921... Kuvendi Popullor shpërndahej".

Priče iz XX veka, Platoneum 2002.

Pyetje:

1. Cilat janë pengesat për zhvillimin e demokracisë në vendet me strukturë të këtillë arsimore?
2. Cila ka qenë situata politike në Mbretëri?
3. Çka dëshironin të arrijnë mbreti dhe administrata?
4. Cilat ishin argumentet e mbretit?
5. A do të ishte sot e mundur të vendoset një kontroll i këtillë?

Burimi 1

Roza Budaji refuzon ta varë flamurin në shtëpinë e saj për ditëlindjen e Mbretëreshës

Departamenti i policisë sekrete shtetërore në Sombor

Evidentuar më: 06.06.1925

Drejtorisë së Policisë Sekrete të Shtetit

Ky departament ka nderin t'ju informojë si në vijim:

Më 27 janar të këtij viti, në ditëlindjen e Lartmadhërisë së Saj mbretëreshës Marija, Roza Bidaji me banim në rrugën Svetozar Miletij nr. 21 nuk ka dashur ta vendosë flamurin në shtëpinë e saj në emër të solemnitetit, por policia e qytetit, duke e njohur që nuk është e prirë pozitivisht ndaj serbëve, urdhëroi që menjëherë shtëpinë ta stolis me flamur. Por pasi që policët u larguan, Roza u shpreh kështu: "Çfarëdo fundërrine që të vij këndeje ne duhet ta nderojmë dhe festojmë...".

Policia menjëherë rastin ia dorëzoi prokurorit shtetëror.

Rozina prica, AJ, fond 37 Milan Stojadinovic, fascikla 4.

Burimi 3

Në burg për shkaka

Gjyqi i qarkut në Čačak, më 31 dhjetor 1931 – Arsyetim i Vendimit për shpalljen fajtor të të pandehurit Milivoje Milovanović, Jevresin Milovanović Kosta dhe Milosav Bujović, nga Lučani, qarku i Dragačevës.

"Janë fajtorë për... në tentim për të shkaktuar mendim të keq kundër rendit politik dhe social në vend, bartje të informatave të rrejshme në fshat se Lartmadhëria e Tij mbreti ka marrë dhjet vjet pushim mjekësor, ndërsa kryetari i qeverisë, z. Petar Zhivković, pesë vite pushim mjekësor, dhe që të dy kanë shkuar jashtë vendit dhe me këtë veprim kanë bërë kundërvajtje kundër rendit publik në shtet. Gjyqi e dënon secilin me nga 15 ditë burg... Përveç dënimit me burgim, është shqiptuar edhe dënimi me para nga 100 dinarë në dobi të Fondit për ngritje dhe meremetim të enteve ndëshkuese..."

Arsyetime i dënimit:

"Për të akuzuarin Jevrem: kur i akuzuari Milivoje për L.M. e tij Mbretin dhe kryetarin e Qeverisë fliste që kanë marrë pushim mjekësor dhe kanë shkuar jashtë vendit, i akuzuari Jevrem nuk është dashur t'i përhapë më tej fjalët, por është dashur të heshtë, ndërsa ai, përkundrazi, ka shkuar dhe për këtë ka pyetur te gjykata komunale..."

AJ, 74-12-23.

Burimi 2

Čka ndodh me ata që mendojnë ndryshe

Dënimin për agjitacion – shpërngulje

Sipas dokumenteve të Ministrisë së Arsimit, Sektori i Arsimit Fillor, 08.11.1931, Beograd

Ndihmësi i Ministrisë së Punëve të Brendshme i dërgon shkresë Ministrisë së Arsimit, 06.10.1931.

Sipas raportit të kryesuesit të qarkut të Pejës: "Aco Gjukanović, mësues në fshatin Gjumnovo, dhe Rjako Jovanović, mësues në Vitomircë, qarku i Pejës, nuk janë mbështetës të regjimit të sotëm, ata publikisht bëjnë agjitim dhe i bindin votuesit të mos dalin në votime, përdërisa nuk ka listë opozite... Lus që ata të zhvendosen në ndonjë vend tjetër jashtë qarkut të Pejës".

Ministria e Arsimit e zgjidhi këtë rast me zhvendosjen e mësuesve të përmendur.

Në bazë të dokumenteve të Ministrisë së Arsimit, Departamenti i Shkollave Fillore, 8 nëntor, 1931, Beograd

Burimi 4

Përqeshja e mbretit – dënimi: dëbim nga shkolla

Raport për Ministrinë e Drejtësisë, shtator 1933, Beograd
"Është paraqitur se Radulović Boshko nga Cetina në datën 16 mars në mësonjëtoen e klasës së gjashtë të gjimnazit gjatë kohës së ligjërimit të profesorit Lopiciq Bllazhe për orën diellore, kur ai ka thënë se për këtë duhet një dërrasë, ai me ironi ka qeshur dhe duke treguar në fotografinë e L. M. Tij Mbretit ka thënë: Pse mos ta përdorim këtë fotografi, zotëri profesor?"

Me vërejtje me shkrim në ditarin shkollor është dëshmuar vepra, por duke e pasur parasysh rrethanën që i pandehuri për këtë vepër është dënuar me përjashtim nga të gjitha gjimnazet për përherë dhe që është i mitur, ai lirohet nga çdo dënim tjetër".

AJ, fond 63, fas.br. 96/1933

Burimi 5

Mbikëqyrje e opozitës

Raportim i Kryesisë së Qarkut të Posavinës, 10 tetor 1933, Umka, Drejtorisë Mbretërore të Qarkut, Novi Sad

"Lidhur me çështjen e urdhëresës suaj të 11 shtatorit 1933, kam nderin t'i paraqes emrat e zyrtarëve shtetërorë të cilët me rastin e zgjedhjeve komunale nuk votuan ose votuan për listat e opozitës, edhe atë:

Kataniq Boshko, mësues i shkollës fillore në Umka, votoi për listën e opozitës, edhe pse në mënyrë diskrete iu bë me dije se duhet të ndihmohet që të votohen lista nacionale... Kataniq më herët bënte pjesë në Partinë Komuniste dhe që atëherë ndaj punës së tij bëhet mbikëqyrje e rreptë..."

Petković Ljubisha, mësues i shkollës fillore në fshatin Mislogjin, aspak nuk ka votuar, ndërsa gjatë fushatës zgjedhore ka punuar për listën e opozitës. Përndryshe, Petković është i njohur si kundërshtar i regjimit... kërkojmë që të zhvendoset nga territori i qarkut..."

AJ, fond 66, fas.br. 14, jed. opisa br.37

Burimi 6


Një anekdotë nga koha e diktaturës së Mbretit Aleksandër

Në fqinjësinë tonë jetonte një tregtar, i njohur si përkrahës i madh i HSS-së (Partisë Fshatare Kroate). Shpesh publikisht e kritikonte regjimin me fjalë fyese. Pastaj atë e dërgonin në stacionin policor dhe e merrnin në pyetje, e lodhnin dhe e lëshonin. Dhe gjithnjë kështu. Kishte tre djem dhe një vajzë. Djali i tret i lindi në vitin 1929, pas vrasjes së Stjepan Radiqit dhe vendosjes së diktaturës së mbretit Aleksandër. Djali të tij të fundit ia vendosi emrin Aleksandar për habinë e të gjithëve. Kyr e pyetën çka e shtiu që djali t'ia vendos emrin e mbretit të urryer, u përgjigj me anë të stilit të tij: "Që të mundem lirisht ta shaj". Kështu të gjithë në qytet qeshnin kur ai e thërriste djalin e tij dhe e shante me emrin e plotë.

Dëshmia e M.J. nga Dubrovniku gjatë viteve të 30-ta

Burimi 7

Funerali i Lartmadhërisë së Tij Mbretit Aleksandër Karagjorgjeviq



King's funeral, Black-white Belgrade, (5.04.2012).

Burimi 8

Njerëzit duke qarë në funeralin e mbretit



<http://www.pogledi.rs/diskusije/viewtopic.php?t=18563&sid=8c22c4cf298f28e689db13bd0c012b4b>

Pyetje:

1. Pse Rosa nuk dëshiron ta vendos flamurin shtetëror?
2. A është e mundshme rezistenca nëse nuk ka arsimim?
3. Cila është pozita e njerëzve të zakonshëm në diktaturë?
4. Kush rezistonte?
5. Cilat liri ishin të reduktuara? Si ndikoi kjo në jetën e njerëzve?

Burimi 1

Administrata dhe korrupsioni

1925

"Administrata në këtë vend është joefikase, e organizuar keq dhe e korruptuar. Përderisa në Serbi para lufte kishte 40.000 administratorë, numri i tyre pas luftës u rrit në 280.000, edhe pse Jugosllavia kishte tre herë më shumë popullsi sesa Serbia para lufte... Korrupsioni lulëzon nga niveli i më i lartë deri te më i ulëti".

Zivko Avramovski, "Britanci u Kraljevini Jugoslaviji", Zagreb, 1988..

Burimi 2

Shikim nga lart... gjendja në vendet fqinje

1925... Mund të kalojë shumë kohë para se të zhduket atmosfera e pashëndetshme në Beograd dhe vështirë që mund të presim që një shtet ballkanik të miratojë metoda efikase të qytetërimit perëndimor, përveç nëse nuk vjen deri te forcimi i mëturjes së kulturës evropiane. Megjithatë, me guxim mund të pohojmë se, qoftë sipas raporteve të saja ndërkombëtare, ashtu edhe sipas gjendjes së saj të brendshme, ky vend qëndron më mirë dhe fqinjët e tij".

Zivko Avramovski, "Britanci u Kraljevini Jugoslaviji", Zagreb, 1988..

Burimi 3

Vendet evropiane që vendosën diktaturë në periudhën mes luftërave


"Evropa mes dy luftërave botërore përbëhej nga gjithsejtë 29 shtete. Në vitin 1920 të gjitha këto vende përveç tre prej tyre mund të përshkruhen si diktatura. Deri në fund të vitit 1938 jo më pak se 16 prej këtyre vendeve u bënë diktatura. Udhëheqësit e tyre kishin fuqi absolute e cila ishte mbi çdo kufizim kushtetuese. Nga 12 diktaturat që mbetën, shtatë u shkatërruan në periudhën 1939-1940. Kështu nga fundi i vitit 1940, në Evropë të paprekura mbetën vetëm pesë demokraci: Britania e Madhe, Irlanda, Suedia, Finlanda dhe Zvicra.

Diktatura u vendosën në Hungari (1920), Poloni (1926), Austri (1932), Lituani (1926), Latvi (1934), Estoni (1934), Shqipëri (1928), Jugosllavi (1929), Bullgari (1934), Rumani (1938), Greqi (1936), Spanjë (1923-1929 dhe pas luftës qytetare) dhe Portugali (1932).

S.J. Lee, *The European dictatorship 1918-1945*, London 1987, 1-3.

Burimi 4

Harta tregon të gjitha shtetet evropiane që vendosën diktaturë në periudhën mes luftërave



Legjenda e hartës

Ngjyra e kuq tregon vendet të cilat vendosën diktaturë.

Ngjyra e kaltër tregon shtetet të cilat mbetën demokratike.

Burimi 5

Reagimet e emigrantëve politikë ndaj diktaturës

"Më 5 janar kryhen dy vite që nga shpallja e diktaturës ushtarake – fashiste në Jugosllavi. Dy vite udhëheqje pa "ndërmjetësues", e drejtpërdrejtë dhe e përgjakshme e dorës së bardhë të mbretit, territ dhe padrejtësisë, nënshtrimit dhe plaçkitjes. Dy vite terrori të tmerrshëm ushtarako – policor, vrasjeve masive, serbizimit dhe krijimit me forcë të një kombi, denacionalizimit, kolonizimit dhe plaçkitjes së popujve të robëruar joserbë në Maqedoni, Kosovë, Mal të Zi, Kroaci etj... Për këtë arsye regjimi tetëmbëdhjetë vjeçar i Beogradit në Maqedoni nuk është asgjë tjetër përveç një terrori i përgjakur i vrasjeve masive dhe nënshtrimit nacional. Mijëra maqedonas ranë nga plumbi ose thika e organeve të pushtetit. Dhjetëra mijëra u arrestuan, janë inskenuar dhjetëra procese politike, dhjetëra dënime me vdekje janë shqiptuar ndaj maqedonasve. Mbyllen shkollat, është ndaluar gjuha amtare, janë serbizuar emrat dhe mbiemrat politikë. Korrupsioni i tmerrshëm mbizotëron në Maqedoni".

M

.128 1931

Pyetje

1. Si e shihte gjendjen në Mbretëri ambasadori britanik?
2. Cilat probleme të sotme janë të ngjashme me problemet e asaj periudhe?
3. Si do t'i zgjidhnit ju këto probleme (pa diktaturë)?
4. Si ishte situata politike në vendet tjera evropiane?